



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 153

Tiranë – E martë, 1 gusht 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 52, datë 24.7.2017	7267
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 53, datë 24.7.2017	7273
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 54, datë 24.7.2017	7278
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 55, datë 24.7.2017	7280
Kërkesë e Ministrisë së Zhvillimit Urban nr. 4144, datë 20.7.2017	7283
	7284



VENDIM

Nr. 52, datë 24.7.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 30.5.2017 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 13 Akti, që i përket:

KËRKUES: Rajmond Toptani

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Rea Merepeza, Edward Toptani, Marion Toptani, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr. 00-2015-4277, datë 21.12.2015 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/1/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vladimir Kristo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkesit, që është shprehur për pranimin e kërkesës, parashtrimet e subjekteve të interesuara, Edward Toptani dhe Marion Toptani, që kanë kërkuar edhe ata pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Me vendimin nr. 828, datë 8.4.1996, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) Tiranë, subjekteve të shpronësuar, Mehmet Ali dhe Ferdin Toptani, trashëgimtarë të Zija dhe Sadete Toptanit, u është njohur pronësia mbi një sipërfaqe trualli prej 6724 m² dhe objekte, duke u kthyer si i lirë trualli prej 5000 m² dhe shtëpia mbi të.

2. Këtë pasuri, shtetasi Zija Toptani ia kishte shitur gruas së tij Sadete dhe kjo e fundit ua kishte dhuruar djemve të saj të mitur, Mehmet Ali dhe Ferdin Toptani, të cilët i kanë regjistruar këto veprime në regjistrat përkatës të hipotekave të kohës (viti 1936).

3. Shtetasi Zija Toptani ka qenë i martuar edhe më parë dhe ka pasur disa fëmijë, të cilët kanë qenë madhorë në momentin e vdekjes së Sadete dhe Zija Toptanit.

4. Në vitin 1996, shtetasja Rea Merepeza, trashëgimtare e fëmijëve nga martesja e parë e Zija Toptanit, ka ngritur padi për kundërshtimin e vendimit nr. 828, datë 8.4.1996 të KKKP-së Tiranë dhe ka kërkuar që prona t'u kthehej të gjithë trashëgimtarëve të Zija Toptanit, sipas dëshmimeve përkatëse të trashëgimisë.

5. Në atë gjykim ajo ka paraqitur në cilësinë e provës akt gjykimin nr. 130, datë 15.11.1942, të Gjykatës së Tiranës, ku në dispozitiv janë deklaruar të pavlefshme të gjitha shitjet “fiktive” të Zija Toptanit për gruan e tij Sadete dhe fëmijët nga martesja e dytë.

6. Me vendimin nr. 9955, datë 17.12.1996, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin e padisë së shtetasës Rea Merepeza, duke disponuar njohjen e të drejtave të pronësisë në vendimin nr. 828, datë 8.4.1996, të KKKP-së Tiranë për të gjithë trashëgimtarët e Zija Toptanit. Ky vendim ka marrë formë të prerë.

7. Në vitin 2002, trashëgimtarët Toptani i janë drejtuar gjykatës me padi, me objekt deklarimin të falsifikuar të dokumentit “akt gjykimi” të vitit 1942, mbi bazën e të cilit subjekti i interesuar Rea Merepeza është njohur bashkëpronare mbi pasuritë objekt konflikti gjyqësor. Mbi bazën e provave të administruara në atë gjykim, me vendimin nr. 4068, datë 21.10.2002, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin e padisë, duke e shpallur të falsifikuar shkresën “**akt gjykimi nr. 421 i aktit, 130 i gjykimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, DC të datës 15.11.1942**”.

8. Bazuar në vendimin gjyqësor nr. 4068, datë 21.10.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kërkesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Me



vendimin nr. 18, datë 18.5.2007, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e kërkesës, si e paraqitur jashtë afatit ligjor, pasi sipas saj kërkuesi e ka paraqitur kërkesën në vitin 2006, pra pas rreth katër vjetëve nga lindja e shkakut të rishikimit.

9. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, e cila, me vendimin nr. 55, datë 16.6.2009, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

10. Me shkresën e datës 25.2.2009, kërkuessit, në bazë të kërkesës së tij, i është vënë në dispozicion nga Arkivi Qendror i Shtetit (AQSH) një seri dokumentesh arkivore, në bazë të të cilave ai i është drejtuar sërish Gjykatës së Lartë me kërkesën për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 9955, datë 17.12.1996, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

11. Me vendimin nr. 00-2012-2676, datë 21.12.2012, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e kërkesës së paraqitur nga kërkuessit Rajmond Toptani, Marion Toptani dhe Edward Toptani, për arsye se është paraqitur jashtë afatit 1-vjeçar nga koha që vendimi ka marrë formë të prerë.

12. Edhe kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, e cila, me vendimin nr. 17, datë 24.3.2014, ka vendosur pranimin e kërkesës, shfuqizimin si të papajftueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2012-2676, datë 21.12.2012, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

13. Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 17, datë 24.3.2014, ka arsyetuar, ndër të tjera: *“Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, është ndalur në verifikimin e respektimit të afatit 30-ditor nga marrja dijani (neni 496 i KPC-së) dhe atij njëvjeçar nga marrja formë të prerë e vendimit që kërkohet të rishikohet (neni 445 i KPC-së), por nuk ka vlerësuar respektimin e një afati tjetër prekluziv, atë njëvjeçar nga momenti i lindjes së shkakut të rishikimit (neni 496 i KPC-së). Interpretimi i dispozitave procedurale që rregullojnë institutin e rishikimit të një vendimi të formës së prerë lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me standardet kushtetuese të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në drejtim të aksesit në*

gjykatë, ndaj ato mund të bëhen objekt i kontrollit të kësaj Gjykate”. Gjykata ka vlerësuar se “përmbajtja e nenit 445 të KPC-së mund të lexohet vetëm duke e harmonizuar me përmbajtjen e nenit 496 të KPC-së, pasi një interpretim dhe zbatim i ndryshëm i kësaj dispozite (stricto sensu) cenon thelbin e së drejtës për t’iu drejtuar gjykatës”. Sipas Gjykatës: “Në çështjen konkrete, neni 445 i KPC-së duhet interpretuar nga Gjykata e Lartë jo në mënyrë të shkëputur, por duke e parë atë në lidhje me nenin 496 të KPC-së, që parashikon afatet e posaçme për paraqitjen e kërkesës për rishikim”. Gjykata ka arritur në përfundimin se “Gjykata e Lartë, duke vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim, u ka cenuar kërkuessve të drejtën e aksesit në gjykatë ...” (shih paragrafët 24-25-26-27-34 të vendimit nr. 17, datë 24.3.2014, të Gjykatës Kushtetuese).

14. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në rishqyrtimin e çështjes pas shfuqizimit të vendimit të mësipërm, me vendimin nr. 00-2015-4277, datë 21.12.2015, ka vendosur përsëri mospranimin e kërkesës së paraqitur nga kërkuessit Rajmond Toptani, Marion Toptani dhe Edward Toptani.

II

15. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), duke pretenduar shfuqizimin e vendimit objekt kërkesë, pasi i ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor në këto drejtime:

15.1 Është cenuar standardi kushtetues i arsyetimit të vendimeve gjyqësore. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e ka mbështetur arsyetimin e tij në interpretime subjektive dhe jo në faktet e parashtruara nga kërkuesi dhe të pasqyruara në provat e depozituara.

15.2 Është cenuar e drejta për t’u dëgjuar dhe parimi i kontradiktoritetit, sepse Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit në dhomë këshillimi pa e kaluar çështjen në seancë gjyqësore.

15.3 Është cenuar e drejta e aksesit në Gjykatën e Lartë. Kërkesa për rishikim ishte përpiluar në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit, si nga ana formale, ashtu edhe në përmbajtje.

15.4 Është cenuar parimi i barazisë së shtetasve para ligjit. Gjykata e Lartë në çështje analoge ka mbajtur qëndrime të ndryshme



lidhur me kërkesat për rishikimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për sa i përket trajtimit të provave të reja të gjetura e të tërhequra në një kohë të mëvonshme nga Arkivi Qendror i Shtetit (AQSH), të cilat qëndrojnë në bazë të kërkesës për rishikim.

15.5 Është cenuar parimi i paanshmërisë, pasi në trupin gjykues ka marrë pjesë gjyqtari A.B., bashkëshortja dhe vajza e të cilit janë mikeshja të ngushta me dy nga palët e paditura në proces (N. L. dhe A. B.).

16. **Subjektet e interesuara**, Edward Toptani dhe Marion Toptani, kanë parashtruar si më poshtë vijon:

16.1 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit ka marrë atributet e seancës gjyqësore, pasi ka shqyrtuar nëse shkaqet e paraqitura përbëjnë arsye për rishikimin e vendimit të formës së prerë.

16.2 Është cenuar standardi kushtetues i arsyetimit të vendimeve gjyqësore. Përfundimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nuk vjen si rrjedhojë logjike e verifikimit dhe shqyrtimit të fakteve dhe akteve që ndodhen në dosjen gjyqësore, por është një interpretim subjektiv dhe arbitrar i tij.

16.3 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e kërkesës në dhomën e këshillimit pa e kaluar çështjen në seancë gjyqësore, duke cenuar kështu të drejtën për t'u dëgjuar, si dhe parimin e kontradiktoritetit.

16.4 Është cenuar parimi i barazisë së shtetasve para ligjit, pasi Gjykata e Lartë në çështje analoge ka mbajtur qëndrime të ndryshme lidhur me kërkesat për rishikimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për sa i përket trajtimit të provave të reja të gjetura në një kohë të mëvonshme nga Arkivi Qendror i Shtetit (AQSH).

16.5 Është cenuar parimi i paanshmërisë. Relatori i çështjes A. B., bazuar në nenin 72/6 të KPC-së, nuk duhet të merrte pjesë në gjykim, sepse bashkëshortja dhe vajza e tij, nga rrejet sociale, rezultojnë se kanë lidhje miqësore me dy nga palët e paditura në proces (N. L. dhe A. B.).

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkesës

17. Kërkuesi legjitimohet *ratione personae* në lidhje me pretendimet e paraqitura në kërkesë, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

18. Gjithashtu, Gjykata çmon se kërkuesi, *prima facie*, legjitimohet edhe *ratione materiae*, pasi pretendimet e tij hyjnë në juridiksionin kushtetues. Këto pretendime janë shqyrtuar në vijim në këndvështrim të standardeve që imponon procesi i rregullt ligjor në kuptimin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit në gjykatë dhe të parimit të gjykatës së caktuar me ligj

19. Kërkuesi pretendon se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë për mospranimin e kërkesës për rishikim bie ndesh me garancitë kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, veçanërisht në drejtim të së drejtës së aksesit në gjykatë, pasi edhe pse kërkesa për rishikim ishte përpiluar në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit, si nga ana formale, ashtu edhe në përmbajtje, Gjykata e Lartë nuk e mori atë në shqyrtim në seancë gjyqësore. Në këtë mënyrë sipas kërkesës, por edhe nga parashtrimet e subjekteve të interesuara, Edward Toptani dhe Marion Toptani, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit ka marrë atributet e seancës gjyqësore, pasi ka shqyrtuar nëse shkaqet e paraqitura përbëjnë arsye për rishikimin e vendimit të formës së prerë.

20. Në jurisprudencën e saj, Gjykata është shprehur se e drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një nga elementet më të rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ). Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të



jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Në këtë këndvështrim, Gjykata ka theksuar se e drejta për t'iu drejtuar gjykatës përbën një garanci për administrimin e mirë të drejtësisë, prandaj çdo interpretim i ngushtë i nenit 42 të Kushtetutës dhe i nenit 6 të KEDNJ-së nuk përputhet me qëllimet dhe objektin e këtyre dispozitave (*shih vendimin nr. 18, datë 15.3.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'iu siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një nga aspektet e së drejtës për gjykim, e sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës. Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 25, datë 10.5.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Nga ana tjetër, Gjykata ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është edhe shqyrtimi i çështjes nga një “gjykatë e caktuar me ligj”. Ky element karakterizohet, në sensin material, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin mbi çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar mbi një procedurë ligjërish të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t'iu dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t'i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimin nr. 2, datë 29.1.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në rastin konkret, Gjykata vëren se çështja është rishqyrtuar në Gjykatë të Lartë pas vendimit nr. 17, datë 24.3.2014, të Gjykatës Kushtetuese. Detyra e lënë nga kjo Gjykatë lidhur me legjitimitimin *ratione temporis* të kërkesit është përmbushur nga Gjykata e Lartë, e cila ka arsyetuar se kërkesa për rishikim është depozituar brenda afateve kohore të

parashikuara nga KPC-ja (*shih paragrafin nr. 19-19/1 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Për sa i përket objektit të gjykimit, ai konsiston në rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë që kishte njohur bashkëpronarë mbi pasuritë objekt konflikti gjyqësor edhe fëmijët nga martesja e parë e trashëgimlënësit. Si bazë për paraqitjen e kërkesës, kërkuesi, bazuar në nenin 494/a të KPC-së, ka paraqitur disa dokumente shkresore të nxjerra nga AQSH-ja, për të cilat ka pretenduar se nuk kishte njohuri në momentin e zhvillimit të gjykimit të themelit.

24. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në vendimin e tij në dhomën e këshillimit është ndalur në analizën e përmbushjes së kriterëve të përcaktuara në nenin 494/a të KPC-së dhe, pa i hyrë vlerësimit të rëndësisë së dokumenteve të pretenduara si “prova të reja”, ka çmuar se në rastin në shqyrtim ato nuk plotësojnë kushtin “*të mos kenë qenë e as mund të ishin në dijeni të kërkuetit*”, pasi nga aktet rezulton se kërkuesi është vënë në dijeni të tyre nga AQSH-ja me shkresën e datës 25.2.2009, në përgjigje të kërkesës të tij, pra këto prova kanë ekzistuar pranë AQSH-së dhe pala kishte mundësi t'i merrte në çdo kohë. Po sipas Gjykatës së Lartë, në dosjen gjyqësore në gjykime të mëparshme mbi themelin e çështjes janë administruar dokumente të tjera lidhur me këtë çështje, të tërhequra nga kërkuesi pranë AQSH-së. Kolegji Civil, gjithashtu, ka çmuar se nuk mund të flitet për “*pamundësi apo mosdijeni*”, pasi dokumentet ndodheshin në Arkivin e Shtetit dhe mund të kërkoreshin e tërhiqeshin nga pala e interesuar dhe se kërkuesi nuk ka trajtuar në kërkesë “*pamundësinë*” e marrjes së dokumenteve nga AQSH-ja më parë dhe pse “*mosdijenit*” nuk ka ardhur “*për faj (neglizhencë) të tij*” (*shih paragrafin nr. 23/3 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Për këtë arsye, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim.

25. Në jurisprudencën e Gjykatës kërkesa për rishikim përfaqëson një formë të veçantë ankimi, një mjet të jashtëzakonshëm, me anë të të cilit kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të Gjykatës. Kërkesa për rishikimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë shqyrtohet nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit pa pjesëmarrjen e



palëve. Ky kolegji verifikon fillimisht rastet e rishikimit, legjitimitetin e kërkesit, bazueshmërinë në ligj dhe në prova të kërkesës për rishikimin e vendimit, si dhe praninë e kritereve ligjore për shqyrtimin e saj. Kur kërkesat e ligjit për kalimin në seancë nuk janë plotësuar, dhoma e këshillimit vendos mospranimin e kërkesës për rishikim (*shih vendimin nr. 19, datë 1.4.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Duke pasur parasysh qëllimin dhe natyrën e këtij mjeti të veçantë ankimi, Gjykata ka theksuar se mospranimi i kërkesës për rishikim i heq përfundimisht palës mundësinë për rihapjen e procesit gjyqësor. Për këtë arsye është e nevojshme që dhoma e këshillimit të japë një vendim të arsyetuar për shkaqet që e kanë çuar atë në marrjen e një vendimi të tillë (*shih vendimin nr. 61, datë 27.9.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Po në këtë drejtim, GJEDNJ-ja (*çështja Bujnita kundër Moldavisë, 16 janar 2007 dhe çështja Xberaj kundër Shqipërisë, 29 korrik 2008*) ka theksuar se autoriteti që ushtron kompetencën e rishikimit të një akti ose procesi duhet të bëjë të gjitha përpjekjet e mundshme për të gjetur një balancë të drejtë midis interesave të individit dhe nevojës për të siguruar efektivitetin e sistemit të drejtësisë (*shih edhe vendimin nr. 5, datë 6.3.2009, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Për shkak të rëndësisë që paraqet instituti i rishikimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin unifikues nr. 1, datë 31.1.2006, kanë theksuar se nëse në dhomën e këshillimit Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë konstaton se faktet e paraqitura nga pala e interesuar mund të jenë shkaqe për rishikim të një vendimi të formës së prerë, çështja nuk vendoset në dhomën e këshillimit, por në seancë gjyqësore duke njoftuar palët për të marrë pjesë në gjykim. Gjykimimi në seancë gjyqësore në këtë rast nuk është një gjykim themeli, por një seancë dëgjimore, ku secila nga palët pjesëmarrëse në gjykim, pasi gjykata të zbatojë parimin e kontradiktoritetit, paraqet argumente rreth shkaqeve që ligji kërkon për rishikimin. Sipas vendimit unifikues, rrethana ose prova e zbuluar duhet të plotësojë këto kushte: a) të ketë rëndësi esenciale për zgjidhjen e çështjes të tillë që sikur gjykata të kishte qenë

në dijeni të saj vendimi që do të jepte, do të ishte i ndryshëm nga ai që ka dhënë; b) të jetë zbuluar rishtaz, të mos ketë qenë, as që mund të ishte në dijeni të kërkesit në kohën e dhënies së vendimit nga ana e gjykatës; c) të jetë një rrethanë në lidhje me një fakt që nuk është pranuar nga ana e gjykatës.

28. Gjykata konstaton se në rastin në shqyrtim Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit është ndalur vetëm në analizën e përmbushjes së kushtit që provat e reja “*të mos kenë qenë e as mund të ishin në dijeni të kërkesit*”, duke arritur në përfundimin se ky kusht nuk plotësohet. Nisur nga roli i Gjykatës së Lartë që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, Gjykata çmon se në çështje të kësaj natyre, në drejtim të respektimit të së drejtës së aksesit në gjykatë, por edhe të parimit të gjykatës së caktuar me ligj, përmbushja e kritereve që duhet të plotësojë prova e re në kërkesën për rishikim, të përcaktuara nga vendimi unifikues, duhet të shqyrtohet në seancë dëgjimore, pra në seancë gjyqësore.

29. Gjykata thekson se shqyrtimi i kërkesës për rishikim në seancë gjyqësore, pasi është verifikuar paraqitja e saj sipas kritereve ligjore në dhomën e këshillimit, ka të bëjë me analizimin në thelb të shkaqeve të rishikimit. Ky vlerësim i përket seancës gjyqësore edhe për faktin se vetëm gjatë shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore, palët kanë mundësi të realizojnë të drejtën e tyre për t'u dëgjuar, si dhe parimin e kontradiktoritetit, si elemente përbërëse të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Gjykata e Lartë nuk duhet të mjaftohet me një trajtim formal të çështjes, por duhet që pavarësisht situatës juridike të marrë të gjitha masat që e drejta e aksesit të garantohet efektivisht. Në këtë kuptim, Gjykata e Lartë në rastin në shqyrtim ishte e detyruar ta kalonte çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore.

30. Gjykata vëren gjithashtu se kërkesi ka pretenduar se duke vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim në dhomën e këshillimit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka cenuar edhe të drejtën për t'u dëgjuar, parimin e kontradiktoritetit, si dhe standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

31. Gjykata vlerëson të mos i analizojë këto pretendime në kushtet kur, për shkak të cenimit



të së drejtës së aksesit në gjykatë dhe të parimit të gjykatës së caktuar me ligj, çështja do të shqyrtohet përsëri në Gjykatën e Lartë. Referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, Gjykata ka theksuar se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Ky raport ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale në bazë të nenit 131/1/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit). Gjykata nënvizon se roli i Gjykatës së Lartë, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme. Ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për ta bërë vetë këtë rol aktiv, që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta (*shih vendimin nr. 62, datë 23.9.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

C. Për pretendimin për cenimin e parimit të barazisë së shtetasve para ligjit

32. Sipas kërkesit është cenuar parimi i barazisë së shtetasve para ligjit, pasi Gjykata e Lartë në çështje analoge ka mbajtur qëndrime të ndryshme lidhur me kërkesat për rishikimin e vendimeve gjyqësorë të formës së prerë, për sa i përket trajtimit të provave të reja të gjetura e të tërhequra në një kohë të mëvonshme nga AQSH-ja, të cilat qëndrojnë në bazë të kërkesës për rishikim.

33. Gjykata ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore. Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia para ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta. Megjithatë, parimi i barazisë nuk e ndalon trajtimin e diferencuar, por trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë mund të përligjet vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive (*shih vendimin nr. 60, datë 16.9.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Nga sa më lart, në rastin në shqyrtim, Gjykata vlerëson se kërkesi nuk ka arritur të provojë se në çështjen objekt shqyrtimi është cenuar parimi i barazisë së shtetasve përpara ligjit.

C. Për pretendimin për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme

35. Kërkesi pretendon, gjithashtu, cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, pasi në trupin gjykues ka marrë pjesë gjyqtari A. B., bashkëshortja dhe vajza e të cilit janë mikeshja të ngushta me dy nga palët e paditura në proces (N. L. dhe A. B.). Ky fakt, sipas kërkesit, rezulton nga komunikimet e këtyre të fundit në rrjetet sociale.

36. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjyqimeve nga gjyqtarët për çështjen e shtruar përpara tyre. Respektimi i këtij parimi duhet të verifikohet duke zbatuar dy teste, testin subjektiv, i cili në thelb kërkon të provuarit e faktit se bindja personale e një gjyqtari ka ndikuar në vendimin e gjykatës dhe, gjithashtu, testin objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. Në kuptim të testit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta. Për sa i përket testit objektiv, ai nënkupton se veç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër edhe dukja e jashtme ka rëndësi. Për rrjedhojë, kur vlerësohet nëse në një çështje konkrete ka një arsye të përligjur që rrezikon paanshmërinë e një trupi gjykues, këndvështrimi i atyre që paraqesin këtë pretendim ka rëndësi, por vendimtar mbetet përcaktimi nëse ky dyshim është objektivisht i justifikueshëm (*shih vendimin nr. 11, datë 3.3.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vlerëson se kërkesi nuk ka parashtruar ndonjë argument bindës në mbështetje të këtij pretendimi, prandaj ai është haptazi i pabazuar.



38. Si përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuetit për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë është i bazuar dhe se kërkesa në këtë drejtim duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/1/f dhe nenit 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2015-4277, datë 21.12.2015, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Vladimir Kristo, Fatos Lulo

VENDIM

Nr. 53, datë 24.7.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Vitore Tusha	anëtare	e	“	“
Vladimir Kristo	anëtar	i	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar	i	“	“
Gani Dizdari	anëtar	i	“	“
Fatos Lulo	anëtar	i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar	i	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 31.5.2017, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 20 Akti, që i përket:

KËRKUES: Përparim Zyka

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Procredit Bank sh.a., Agim Gjergji, Iljaz Dedej, Majlinda Dedej, Domenik Dedej, Zyra e Përmbarrimit Shtetëror Durrës, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 00-2016-2570, datë 19.9.2016, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

Pezullimi i ekzekutimit të vendimeve nr. 336, datë 14.4.2015, të Gjykatës së Apelit Durrës dhe nr. 00-2016-2570, datë 19.9.2016, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4/1, 5, 42, 131/f dhe 134, pikat 1/i dhe 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6/1 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Besnik Imeraj, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuetit, që është shprehur për pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Domenik Dedej dhe ProCredit Bank, që janë shprehur për pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Nga materialet e çështjes në shqyrtim rezulton se kërkueti Përparim Zyka ka qenë palë e paditur në një proces gjyqësor civil në lidhje me një sipërfaqe toke të ndodhur në Shkallnuer të rrethit të Durrësit.

2. Me vendimin nr. 472, datë 19.2.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur: “Pranimin e kërkesëpadisë së palës paditëse A. Gj. 1. Të konstatohet pavlefshmëria absolute e urdhrimit të përmbarrimit nr. 371 Prot., datë 22.7.2002, dhe regjistrimit përkatës nga ZVRPP-ja Durrës. 2. Detyrimin e të paditurit “ProCredit Bank” sh.a. që të shohë të drejtën e paditësit A. Gj. të pronësisë mbi pasurinë nr. 2455/40, me sipërfaqe 485 m² Z. K. 3385, e ndodhur në Shkallnuer, për sipërfaqen prej 388 m². 3. Urdhërimi i ZVRPP-së Durrës që të fshejë



“Fefad Banka” sot “ProCredit Bank” sh.a., si pronare me mbivendosje, mbi pasurinë nr. 245/40 Z. K. 3385, me sipërfaqe 485 m², Shkallnuer Durrës. 4. Të konstatohet si veprim juridik absolutisht i pavlefshëm kontrata e shitblerjes nr. 1788 Rep. dhe nr. 562/1 Kol., datë 14.9.2010, kthimi i palëve në gjendjen e mëparshme dhe detyrimi i të paditurit Përparim Zyka të njohë paditësin A. Gj. pronar mbi këtë pronë. 5 Marrja e masës së përkohshme për sigurimin e objektit të padisë: lënia në fuqi e urdhrin të regjistruarit nr. 2892, datë 10.5.2012, për kushtimin e pasurisë 245/90 Z. K. 3385, Shkallnuer, vol. 20, fq. 113, me sipërfaqe 2235 m² dhe nr. 245/89, Z. K. 3385, në pronësi të të paditurit I. D., deri në përfundimin e gjykimit të çështjes. Rrëzimin e kundërpadisë të të paditurit “ProCredit Bank”...”.

3. Me vendimin nr. 336, datë 14.4.2015, Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur: “Lënia në fuqi të vendimit nr. 472, datë 19.2.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.”. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs edhe kërkuesi Përparim Zyka.

4. Me vendimin nr. 00-2016-2570, datë 30.9.2016, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekurseve të paraqitura, me arsyetimin se nuk përmbajnë shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (KPC).

II

5. **Kërkuesi Përparim Zyka** i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit, duke paraqitur këto shkaqe në mënyrë të përmbledhur:

5.1 Është cenuar parimi i barazisë së armëve në gjykim. Në gjykatën e shkallës së parë gjykimi është zhvilluar në mungesë të kërkuesit.

5.2 Paditësi nuk ka pasur pretendime pronësie ndaj kërkuesit dhe për këtë arsye nuk e ka thirrur atë në proces si palë të paditur, por ai është thirrur në cilësinë e palës së paditur gjatë gjykimit nga gjykata. Gjykata edhe pse ka pasur adresën e deklaruar nga vetë kërkuesi sipas kontratës, nuk ka bërë njoftimin me fletëthirrje në këtë adresë.

5.3 Gjykata e shkallës së parë ka rrëzuar kërkesën e palës së paditur “ProCredit Bank” sh.a. për mosmbylljen e hetimit gjyqësor, duke i mohuar njërës palë në gjykim të drejtën e aksesit. Kjo e bën procesin të parregullt dhe të pabarabartë.

5.4 Kërkimi i paditësit për shtim të objektit të padisë dhe kërkesat e tjera të tij që nuk kishin lidhje me katër kërkimet në padinë kryesore përbëjnë një padi të re, çka përbën shtim të objektit të padisë, kërkesë që duhej të ishte rrëzuar nga gjykata.

5.5 Gjykata e Apelit Durrës nuk i ka marrë në shqyrtim shkeljet e konstatuara gjatë gjykimit në shkallë të parë, duke mos u dhënë përgjigje në vendimin e saj.

5.6 Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtën e aksesit dhe të ankimit efektiv, pasi nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në rekurs. Refuzimi i Gjykatës së Lartë për të kaluar çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore dhe për të dëguar pretendimet e kërkuesit ka cenuar edhe parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj.

6. **Subjekti i interesuar Domenik Dedej** ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur sa më poshtë:

6.1 Planrilevimi për sipërfaqen e tokës objekt shqyrtimi nuk është bërë nga Ferdinand Tola. Këtë fakt e ka pohuar edhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës.

6.2 Akti i mësipërm është i falsifikuar dhe nuk është pjesë e dokumenteve të shitjes së pronës.

6.3 Çështja civile objekt shqyrtimi është zhvilluar dhe bazuar në dokumente të rreme dhe të falsifikuara.

7. **Subjekti i interesuar Procredit Bank** ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur sa më poshtë:

7.1 Shkaqet e paraqitura në kërkesën ankimore nga kërkuesi Përparim Zyka janë të bazuara.

7.2 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka shkelur haptazi rregullat e njoftimit për të paditurin Përparim Zyka.

7.3 Gjykata e ka bërë njoftimin e kërkuesit Përparim Zyka në një adresë të pasaktë dhe nuk e ka dërguar njoftimin në adresën që kërkuesi ka deklaruar në aktet shkresore që ndodheshin në dosje.

7.4 Gjykata e Apelit Durrës nuk i mori në konsideratë këto shkaqe, duke vijuar me proces të parregullt edhe pse mungesa e njoftimit të palëve është një nga shkaqet e pavlefshmërisë së gjykimit. Të njëjtat shkelje nuk janë marrë në



konsideratë edhe nga Gjykata e Lartë, e cila nuk ka pranuar rekursin e kërkuarit.

8. Subjektet e tjera nuk paraqitën parashtrime.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

9. Kërkuari legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, në kuptim të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, në kuptim të neneve 131/1/f dhe 134/2 të Kushtetutës, pretendimet janë të tilla që *prima facie* bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të barazisë së armëve në gjykim

10. Sipas kërkuarit, gjykimi në shkallë të parë është zhvilluar në mungesë të tij dhe njoftimi është bërë në datën 18.1.2013, akoma pa u marrë vendimi për ta thirrur atë si palë, i cili është i datës 25.1.2013. Pa marrë asnjë lloj konfirmimi për marrjen e tij dijani, gjykata e shkallës së parë në vend që të përsëriste thirrjen, ka vendosur të bëjë shpalljen publike. Paditësi, duke mos dashur që kërkuari të merrte pjesë në gjykim, ka përcaktuar si adresë të tij fshatin Shkallnuer në Durrës, ndërkohë që vendbanimi i tij ka qenë dhe është akoma në fshatin Poliçan të qarkut Berat, fakt që ka qenë i deklaruar në kontratën e shitblerjes të vitit 2010 objekt gjykimi. Pra, gjykata edhe pse ka pasur adresën e deklaruar nga vetë kërkuari sipas kontratës, nuk ka bërë njoftimin me fletëthirrje në këtë adresë. Në Gjykatën e Apelit Durrës janë zhvilluar 6 seanca gjyqësore. Seanca e parë është zhvilluar pa praninë e kërkuarit, duke u zëvendësuar njoftimi me shpalljen publike, kurse për pesë seancat e tjera nuk është bërë asnjë lloj njoftimi publik.

11. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Konkretisht, e drejta për t’u njoftuar për një

gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit. E drejta për t’u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjake në raport me palën kundërshtare (*shih vendimin nr. 37, datë 30.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes palëve. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t’u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit, por duhet që legjislacioni procedural, në radhë të parë, dhe më pas gjyqtari gjatë gjykimit t’u japin mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykim, atëherë argumentet e njëres palë do të mbizotëronin mbi argumentet e palës tjetër, për rrjedhojë e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Bazuar në këto parime, gjykatave të zakonshme u dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve apo përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimin nr. 37, datë 30.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Gjykata ka vlerësuar, gjithashtu, se kontrolli i kushtetutshmërisë së një vendimi gjyqësor vlerësohet në një kontekst të caktuar faktesh që lidhen me të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Rastet që i paraqiten Gjykatës



mbi bazën e ankimit të individëve, duhet të shqyrtohen domosdoshmërisht në bazë të provueshmërisë së fakteve të dhëna. Marrja e vendimit për çështje kushtetuese kushtëzohet nga përcaktimi i fakteve kushtetuese, mbi bazën e të cilave vlerësohet respektimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Përderisa Gjykata Kushtetuese ka autoritetin për të vendosur përfundimisht për çështje të kushtetutshmërisë së procesit gjyqësor, ajo nuk mund ta ushtrojë këtë kompetencë pa analizuar faktet e natyrës kushtetuese (*shih vendimin nr. 5, datë 2.3.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Nga administrimi i akteve të dosjes gjyqësore rezulton se kërkesëpadija është paraqitur kundër palëve të paditura ZVRPP-së Durrës, Zyrës së Shërbimit Përmbarrimor Shtetëror Durrës dhe I. D., dhe çështja është regjistruar në datën 1.6.2012. Në seancën gjyqësore të datës 17.12.2012, pala e paditur ProCredit Bank ka paraqitur kundërshtime për aktin e ekspertimit dhe është shprehur se prona që ka mbivendosje është e shitur me kontratën e datës 14.9.2010, dhe është blerë nga shtetasi Përparim Zyka, duke paraqitur edhe provat përkatëse për këtë qëllim. Në seancën gjyqësore të datës 17.1.2013, pala paditëse është shprehur se do të paraqesë kërkesë për të thirrur shtetasin Përparim Zyka, kërkesë që rezulton të jetë paraqitur në datën 18.1.2013. Për rrjedhojë, me fletëthirrjen e datës 18.1.2013, gjykata ka njoftuar kërkuesin për të marrë pjesë në seancën e datës 25.1.2013. Në seancën e kësaj date, gjykata ka vendosur që të thirret me shpallje kërkuesi Përparim Zyka dhe ka shtyrë seancën gjyqësore. Në datën 25.1.2013, gjykata ka bërë njoftimin me shpallje për këtë shtetas, ku një kopje është afishuar në gjykatë dhe një në ambientet e komunës Rrashbull. Seanca e datës 14.2.2013 është bërë në mungesë të kërkuesit, po ashtu edhe seanca e datës 19.2.2013, datë në të cilën gjykata ka shpallur edhe vendimin e saj. Gjithashtu me shpallje ka proceduar gjykata edhe në lidhje me njoftimin e vendimit të saj për palën në mungesë, kërkuesin Përparim Zyka.

15. Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë ka bërë ankim pala e paditur I. D. dhe ProCredit Bank. Procesi gjyqësor edhe në Gjykatën e Apelit rezulton të jetë bërë në

mungesë të kërkuesit. Po ashtu rezulton se kërkuesi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, ku ka pretenduar, mes të tjerash, edhe parregullsi në njoftimin për gjykimin e çështjes në gjykatat e faktit. Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit, duke vlerësuar se shkaqet e paraqitura në rekurs nuk janë nga ato që parashikon neni 472 i KPC-së, ka vendosur mospranimin e tij.

16. Bazuar në dispozitat procedurale që rregullojnë njoftimin e palëve rezulton se sipas nenit 128 të KPC-së, njoftimi i akteve bëhet sipas mënyrave të parashikuara në këtë kre dhe gjyqtari ose kryetari i trupit gjyqësor të çështjes kujdeset dhe kontrollon procesin e njoftimit, që kryhet nga nëpunësit e administratës gjyqësore të caktuar për realizimin e tij. Kurse kur nuk është i mundur njoftimi sipas dispozitës së mësipërme, sipas nenit 131 njoftimi bëhet në vendbanimin apo vendqëndrimin e personit të thirrur, ose në zyrën apo vendin ku ushtron veprimtarinë tregtare, industriale ose të artizanatit. Neni 133 parashikon se kur personit të thirrur nuk i dihet vendbanimi ose vendqëndrimi në Republikën e Shqipërisë, ose nuk ka zgjedhur një banesë, apo nuk ka caktuar një përfaqësues të tij, sipas nenit 131 të këtij Kodi, njoftimi i aktit bëhet nëpërmjet afishimit të kopjes në gjykatën e vendit, ku do të gjykohej mosmarrëveshja, si dhe në vendin e afishimit, ku ka pasur vendbanimin e fundit. Ky njoftim qëndron i afishuar për jo më pak se 20 ditë.

17. Sipas njoftimit me shpallje të datës 25.1.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës (f. 225 e dosjes gjyqësore) rezulton se njoftimi për kërkuesin ka qenë i pamundur të realizohet me anë të postës dhe se nga deklaratimet në seancë dhe fletëthirrja rezulton se ai është larguar nga adresa e përcaktuar në kërkesëpadi, se ndodhet jashtë shtetit dhe se nuk është autorizuar ndonjë person për komunikimin e ndonjë adrese të re. Në vijim për çdo njoftim për kërkuesin është proceduar me shpallje nga ana e gjykatës. Për më tepër, kërkuesi ka pretenduar se adresa ku janë bërë njoftimet për të nuk është adresa e tij, çka rezulton edhe nga kontrata e administruar si provë nga gjykata.



18. Gjykata vlerëson se kërkuesi ka abuzuar me të drejtat që burojnë nga legjislacioni në fuqi në lidhje me përfaqësimin dhe marrjen pjesë në gjykim. Ai ishte i detyruar të njoftonte paraprakisht gjykatën për ndryshimin e vendbanimit të pranuar dhe deklaruar prej tij në dokumentet zyrtare bashkëlidhur dosjes.

19. Nga aktet e administruara në gjykim rezulton se në dosje ndodhet një prokurë e posaçme noteriale e datës 28.4.2015, me të cilën kërkuesi me vullnetin e tij të plotë ka emëruar si përfaqësues të tij për të ushtruar rekursin para Gjykatës së Lartë avokatin L. M. Gjykata konstaton se në këtë prokurë kërkuesi, ndër të tjera, deklaron se është banues në fshatin Shkallnuer të Durrësit, ndërkohë që në rekursin e paraqitur ka pretenduar që është banues në Poliçan. Po këtë pretendim kërkuesi e ka paraqitur edhe para Gjykatës Kushtetuese, por duke mos sjellë asnjë provë lidhur me të, përkundrazi në prokurën përpiluar para avokatit të tij ka vetëdeklaruar banimin në fshatin Shkallnuer, vendbanim ku dhe gjykatat kanë bërë njoftimin e tij sipas rregullave procedurale.

C. Për procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë

20. Sipas kërkuesit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit, ka cenuar të drejtën e aksesit në kuptimin substancial.

21. Në nenin 42/2 të Kushtetutës parashikohet se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të

pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet nr. 21, datë 20.3.2017; nr. 52, datë 14.11.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në lidhje me shqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Lartë, në jurisprudencë konstante Gjykata ka theksuar se në rast se Kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato shkaqe që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit nuk është një shkelje e së drejtës së palëve për t'iu drejtuar gjykatës, por një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj. Ky lloj shqyrtimi paraprak vlerësues është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi dhe nuk mund të bëhet pjesë e kontrollit kushtetues që zhvillon Gjykata (*shih vendimet nr. 21, datë 20.3.2017; nr. 8, datë 26.2.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Për arsyet sa më lart dhe ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pabazuar.

23. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, janë të pabazuara.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72, 77 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës



Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Gani Dizdari, Besnik Imeraj, Fatos Lulo

VENDIM

Nr. 54, datë 24.7.2017

**NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 27.6.2017 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 22 Akti, që i përket:

KËRKUES: Departamenti i Administratës Publike (DAP)

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Ramis Lleshi

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 00-2016-1648, datë 5.5.2016 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi); nr. 467, datë 9.3.2015, të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 1181, datë 25.3.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Rikthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 16/2, 42, 43 131/1/f dhe 132 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës

Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatos Lulo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkesit, DAP-it, që kërkoj pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Ramis Lleshit, që kërkoj rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Nga dokumentet të cilat shoqërojnë kërkesën rezulton se subjekti i interesuar (Ramis Lleshi) ka qenë i punësuar pranë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETS) në pozicionin “Përgjegjës Sektori” në Sektorin e Lëvizjes së Lirë të Mallrave dhe Masave Ekonomike. Në kuadër të ristrukturimit të kësaj ministrie, atij i është propozuar kalimi në një pozicion tjetër pune, pozicion të cilin e ka refuzuar për shkak të zbritjes së dy niveleve.

2. Subjekti i interesuar i është drejtuar Komisionit të Shërbimit Civil me ankesë, i cili e ka njoftuar për të tërhequr ankesën dhe materialet shoqëruese të saj, pasi ky institucion në mbështetje të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nuk ka juridiksion për shqyrtimin e ankesës.

3. Më pas subjekti i interesuar ka paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 1181, datë 25.3.2014, ka vendosur: *“Pranimin e kërkesëpadisë. Rikthimin e paditësit R. LL. në vendin e mëparshëm të punës ose sistemitin e tij në një pozicion të barasvlershëm me atë, kategoria III-a, në një prej vendeve të lira të krijuara pas ristrukturimit të institucionit, sipas përcaktimeve të ligjit “Për statusin e nëpunësit civil” dhe pagimin e pagës nga momenti i largimit deri në rifillimin e marrëdhënieve të punës”.*

5. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 467, datë 9.3.2015, ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë nr. 1181, datë 25.3.2014”.*



6. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi, me vendimin nr. 00-2016-1648, datë 5.5.2016, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyen se nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

II

7. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duke parashtruar si vijon:

7.1. *Është cenuar parimi i arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur në dhomën e këshillimit mospranimin e rekursit pa marrë në shqyrtim dhe pa u dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në rekurs në lidhje me cenimin e parimit të sigurisë juridike.

7.2. *Është cenuar e drejta e aksesit*, pasi Gjykata e Apelit dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë duke vendosur mospranimin e ankimit i kanë cenuar këtë të drejtë të DAP-it.

7.3. *Është cenuar parimi i sigurisë juridike*, pasi dy gjykatat kanë mbajtur qëndrime të ndryshme lidhur me efektet e vendimit nr. 5/2014 të Gjykatës Kushtetuese dhe në këto kushte Gjykata e Lartë duhej të kishte mbajtur një qëndrim përfundimtar lidhur me këtë çështje.

8. **Subjekti i interesuar Ramis Lleshi** ka pretenduar se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi nuk përmban asnjë element të cenimit të të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, duke parashtruar si vijon:

8.1 Kërkuesi nuk legjitimohet për të paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, pasi nuk ka shteruar mjetet e zakonshme ligjore për t’iu drejtuar kësaj gjykate. Konkretisht, kërkuesi nuk rezulton të ketë paraqitur rekurs pranë Gjykatës së Lartë.

8.2 Pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit është i pabazuar, pasi edhe ky pretendim i nënshtrohet parimit të subsidiaritetit dhe detyrimit për të shteruar mjetet e ankimit. Këtë pretendim kërkuesi nuk e ka ngritur gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë.

8.3 Pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të sigurisë juridike është i pabazuar, pasi

edhe këtë pretendim kërkuesi nuk e ka paraqitur gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

9. Gjykata vëren se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si edhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatë brenda afatit ligjor të përcaktuar në ligjin nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

10. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, sipas nenit 131/1/f të Kushtetutës, individit mund t’i drejtohet Gjykatës për gjykimin përfundimtar të pretendimeve të tij për cenimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte. Kontrolli i ushtruar nga Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit nga një proces i parregullt ligjor, është një kontroll subsidiar, që do të thotë se individit duhet t’i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Shterimi nënkupton se kërkuesi duhet t’i shfrytëzojë, në shkallët e sistemit gjyqësor, të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara të shkelura. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 77, datë 19.12.2016; nr. 3, datë 23.1.2014, të Gjykatës Kushtetuese*). Qëllimi i nenit 131/1/f të Kushtetutës, i cili përcakton rregullin e shterimit të mjeteve juridike, është që të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatën Kushtetuese.

11. Gjykata ka vlerësuar se Kushtetuta duhet interpretuar në atë mënyrë që të ketë kuptimin më të arsyeshëm dhe të frytshëm të mundshëm. Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion *subsidiar*, ajo mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor (*shih*



vendimet nr. 77, datë 19.12.2016; nr. 28, datë 23.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese).

12. Gjykata është shprehur se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Shqyrtimi kushtetues i kërkesave individuale udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit). Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (*shih vendimet nr. 19, datë 2.4.2012; nr. 4, datë 28.2.2006, të Gjykatës Kushtetuese*). Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 77, datë 19.12.2016; nr. 31, datë 25.5.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Gjykata, bazuar në vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, vëren se ajo është vënë në lëvizje me anë të rekursit të paraqitur nga MZHETS-ja, shkaqet e të cilit gjejnë pasqyrim edhe në të. Sipas kërkesit, Gjykata e Lartë ka cenuar parimin e arsytimit të vendimit, sepse nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura prej tij. Për të mbështetur këtë pretendim, kërkuesi bashkëlidhur kërkesës ka paraqitur edhe një kopje të rekursit kundër vendimit nr. 467, datë 9.2.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë, i cili nuk përmban as vulë të gjykatës ku është depozituar dhe as datën e depozitimit të tij. Sipas subjektit të interesuar R. LL., kërkuesi nuk ka paraqitur rekurs kundër vendimit nr. 467, datë 9.2.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Për të verifikuar këtë pretendim të subjektit të interesuar, Gjykata tërhoqi dosjen gjyqësore të kësaj çështje nga aktet e së cilës rezultoi se kërkuesi nuk ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë kundër vendimit nr. 467, datë 9.2.2015, dhe kjo e fundit është vënë në lëvizje vetëm në bazë të rekursit të paraqitur nga MZHETS-ja. Gjithashtu, Gjykata iu drejtua kërkesit për të vënë në dispozicion një kopje të rekursit të lartpërmendur. Në përgjigjen e sjellë nga kërkuesi, ky i fundit nuk arriti të provojë

pretendimin e tij për paraqitjen e rekursit.

14. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se për sa kohë që kërkuesi nuk ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë dhe për rrjedhojë nuk i ka ngritur në atë shkallë të gjykimit pretendimet që ka paraqitur në këtë Gjykatë, ai nuk ka shteruar mjetet ligjore në kuptim të nenit 131/1/f të Kushtetutës.

15. Në përfundim, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet *rationae materiae* për t'iu drejtuar kësaj Gjykate.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

VENDIM

Nr. 55, datë 24.7.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	"	"
Gani Dizdari	anëtar i	"	"
Besnik Imeraj	anëtar i	"	"
Fatos Lulo	anëtar i	"	"
Fatmir Hoxha	anëtar i	"	"

me sekretare Belma Lleshi, në datën 6.6.2017, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 21 Akti, që u përket palëve:



KËRKUES: Albert Noçka, Agim Kroj

SUBJEKT I INTERESUAR: Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Tiranë

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtuësëm me Kushtetutën i vendimit nr. 00-2016-571, datë 3.3.2016, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/1/f, 132/1 dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 28, 30, 76, 81/1 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatmir Hoxha, shqyrtoi pretendimet e kërkuësve, që kërkuan pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP), Tiranë, me vendimin nr. 100/1, datë 26.8.2000, ka vendosur: *“Të njohë shtetasen Natalia Noçka pronare mbi pronën e përbërë nga një parcelë nr. 41, me sipërfaqe 1176 m², e ndodhur në Tiranë, në zonën mbrapa stadiumit “Qemal Stafa”, me kufizimet: nga lindja me rrugë, perëndimi me parcelën 31, jugu me parcelën 33 dhe veriu me shëtitore...”*.

2. Me kontratën e shitjes nr. 1991/433, datë 26.10.2000, shtetasja Natalia Noçka ia ka shitur pasurinë e mësipërme kërkuësve Agim Kroj dhe Albert Noçka, të cilët e kanë regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP), Tiranë.

3. Në vitin 2007, Avokatura e Përgjithshme e Shtetit i është drejtuar Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP) Tiranë për kundërshtimin e vendimit nr. 100/1, datë 26.8.2000, të ish-KKKP-së Tiranë, i dhënë në favor të subjektit të shpronësuar Natalia Noçka.

4. AKKP-ja Tiranë, me vendimin nr. 156, datë 8.8.2007, ka vendosur konstatimin absolutisht të pavlefshëm të vendimit nr. 100/1, datë 26.8.2000 të ish-KKKP-së Tiranë, me arsyetimin se trualli i kthyer në natyrë subjektit të interesuar nuk ishte i lirë, por i zënë

me ndërtime publike, për rrjedhojë ish-pronari duhej të ishte kompensuar. Kundër vendimit të AKKP-së kërkuësit kanë paraqitur kërkesëpadi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt konstatimin të pavlefshëm të tij.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 4428, datë 31.5.2010, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë.

6. Mbi ankimin e kërkuësve, me vendimin nr. 961, datë 4.5.2011, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 4428, datë 31.5.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

7. Me vendimin nr. 00-2012-1645, datë 6.7.2012, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga Albert Noçka dhe Agim Kroj.

8. Mbi kërkesën e kërkuësve, Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 25, datë 21.3.2013, ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 00-2012-1645, datë 6.7.2012, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke argumentuar se gjatë gjykimit Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e paanësisë.

9. Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese çështja është kthyer për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), me vendimin nr. 00-2016-571, datë 3.3.2016, ka vendosur mospranimin e rekursit.

II

10. **Kërkuësit, Albert Noçka dhe Agim Kroj**, i janë drejtuar përsëri Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2016-571, datë 3.3.2016, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, duke pretenduar se është rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor. Kërkuësit, në mënyrë të përmbledhur, kanë parashtruar shkaqet për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

10.1 Është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, pasi kërkuësit nuk kanë pasur të drejtë të marrin pjesë dhe të mbrohen gjatë procedimit administrativ.

10.2 Është cenuar parimi i sigurisë juridike, në aspektin e parimit të të drejtave të fituara dhe pritshmërive të ligjshme që rrjedhin nga



vendimi nr. 100/1 i ish-KKKP-së Tiranë, i cili krijon tek individi të njëjtat pritshmëri që krijon një vendim gjyqësor. Gjykatat nuk kanë respektuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 27, datë 26.5.2010, i cili ka shfuqizuar dispozitat ligjore që i njihnin drejtorit të AKKP-së kompetencën për të shfuqizuar vendimet e ish-KKKP-ve. Edhe pse në rekurs janë parashtruar shkeljet e konstatuara në shkallët më të ulëta të gjykimit, të cilat janë tërësisht brenda fushës së shqyrtimit nga Gjykata e Lartë, kjo e fundit ka vendosur mospranimin e rekursit për shqyrtim në seancë gjyqësore, duke mos korrigjuar mangësitë e gjykatave më të ulëta në plotësimin e standardeve dhe elementeve të një procesi të rregullt ligjor.

11. **Subjekti i interesuar, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë**, nuk ka paraqitur parashtrime me shkrim.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuësve

12. Gjykata vlerëson se kërkuësit legjitimohen *ratione personae*, pasi parashikohen si subjekte nga nenet 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kërkuësit legjitimohen *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit të parashikuar nga ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Lidhur me legjitimitimin *ratione materiae*, kërkuësit kanë pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor pasi nuk kanë marrë pjesë gjatë shqyrtimit administrativ, si dhe cenimin e parimit të sigurisë juridike gjatë gjykimit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, pretendime të cilat hyjnë në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

B. Për themelin e çështjes

B.1. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u thirrur dhe dëgjuar nga organi administrativ

13. Kërkuësit kanë pretenduar së është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, pasi nuk janë thirrur për t'u dëgjuar dhe mbrojtur nga organi administrativ.

14. Gjykata konstaton se pretendimi i kërkuësve është parashtruar si gjatë gjykimit të zakonshëm edhe në kërkesën e mëparshme të

paraqitur në Gjykatën Kushtetuese, e cila me vendimin nr. 25, datë 21.3.2013, pasi e ka shqyrtuar, e ka vlerësuar si të pabazuar.

15. Për sa më sipër, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuësve se është cenuar e drejta për t'u dëgjuar nga organi administrativ konsiderohet gjë e gjykuar.

B.2. Për pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike

16. Kërkuësit në kërkesën e tyre kanë parashtruar se gjatë gjykimit të çështjes nga gjykatat e zakonshme është cenuar parimi i sigurisë juridike në aspektin e parimit të drejtave të fituara dhe pritshmërive të ligjshme që rrjedhin nga vendimi nr. 100/1 i ish-KKKP-së, Tiranë, i cili krijon tek individi të njëjtat pritshmëri që krijon një vendim gjyqësor. Sipas tyre, gjykatat nuk kanë respektuar vendimin nr. 27, datë 26.5.2010, të Gjykatës Kushtetuese, i cili ka shfuqizuar dispozitat ligjore që i njihnin drejtorit të AKKP-së kompetencën për të shfuqizuar vendimet e ish-KKKP-ve. Gjykatat nuk kanë mbajtur në konsideratë faktin e pasojave juridike të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

17. Gjykata ka konstatuar se gjatë gjykimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, kërkuësit kanë paraqitur kërkesë për pezullimin e gjykimit dhe dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese për shqyrtimin e pajtueshmërisë me Kushtetutën e Republikës të neneve 16/1 shkronjat “c” dhe “ç”, dhe 18/1 të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesës për pezullim. Ndërkohë para përfundimit të çështjes në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 27, datë 26.5.2010, ka vendosur shfuqizimin e neneve 15 dhe 16 të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar.

18. Kërkuësit pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike e kanë parashtruar në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë, si dhe në kërkesën e mëparshme të paraqitur në Gjykatën Kushtetuese. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi, me vendimin nr. 00-2012-1645, datë 6.7.2012, ka vendosur mospranimin e rekursit. Gjatë shqyrtimit të çështjes me objekt shfuqizimin e vendimit të sipërcituar të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, Gjykata Kushtetuese



ka vendosur refuzimin e kërkesës për pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike, pasi nuk është arritur shumica e kërkuar për vendimmarrje, dhe pranimin e kërkesës për pretendimin e cenimit të parimit të paanësisë nga Gjykata e Lartë. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë pas rishqyrtimit të çështjes, me vendimin nr. 00-2016-571, datë 3.3.2016, ka vendosur mospranimin e rekursit. Në këto kushte, kërkuarit kanë riparaqitur kërkesën në Gjykatën Kushtetuese, duke parashtruar të njëjtin pretendim lidhur me cenimin e parimit të sigurisë juridike.

19. Gjykata në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë plenare vëren se pretendimi i kërkuarve nuk arriti të merrte shumicën e votave të gjyqtarëve prej 5 anëtarësh të kërkuar nga ligji. Sipas nenit 72/2 të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimet e Gjykatës Kushtetuese merren me shumicën e votave të të gjithë gjyqtarëve të saj. Gjatë shqyrtimit të çështjes, 3 gjyqtarë votuan për pranimin e kërkesës dhe 3 për rrëzimin e saj¹. Nisur nga ky fakt, bazuar në nenin 73 të këtij ligji, për shkak të mosformimit të shumicës prej 5 gjyqtarësh, kërkesa konsiderohet e rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe neneve 72 dhe 73 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Gani Dizdari, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

¹ Votuan për pranimin e kërkesës gjyqtarët: Bashkim Dedja, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha. Votuan për rrëzimin e kërkesës gjyqtarët: Gani Dizdari, Besnik Imeraj, Fatos Lulo.

KËRKESË

Nr. 4144, datë 20.7.2017

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Rikualifikim i qendrës së qytetit, loti 1”, Cërrik.

Subjekti kërkuar i këtij objekti është bashkia Cërrik.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të truallit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerësimit të tokës në Republikën e Shqipërisë” dhe për ndërtimin vlerësimi është bërë në përputhje me udhëzimin nr. 4, datë 30.9.2015, “Për miratimin e kostos mesatare të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2015”, si dhe udhëzimin nr. 21, datë 26.2.2009, të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 2,996,124 (dy milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e njëzet e katër) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI
I ZHVILLIMIT URBAN
Alfred Dalipi



TE DHENAT MBI LISTEN EMERORE E PRONAREVE DHE PRONAVE QE DO TE SHPRONESOHEN PER OBJEKTI: "RIKUALIFIKIMI I QENDRES SE QYTETIT CERRIK", BASHKIA 1- OBJEKTET QE JANE NE RRUGEN "JORGJI DILO" ME ÇERTIFIKATE PRONESIE (Per Objekte, Sherbimit dhe Truallin)

Nr.	Emer Atesia Mbiemer	Zona kadastrale	Nr. Pasurise	Siperfaqja e Objektivit te Banimit (m ²)	Siperfaqja e Truallit (m ²)	Siperfaqja e Objektivit te Sherbimit (m ²)	Cmimi i Objektivit te Banimit (Leke/m ²)	Cmimi Truall (Leke/m ²)	Vlera e Objektivit te Sherbimit sipas Situacionit (Leke)	VLERA E AMORTIZIMI PER NDERTESAT (Koha Venies ne funksion 20-vjet/1% ne vit)	Vlera e mbetur Objektivit te Sherbimit (Leke)	Vlera e Truallit (Leke)	Vlera Totale e Truallit, Objektivit te Banimit dhe Sherbimit (Leke)	Dokumenti i Pronesie
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	12		13	14	15
1	Arben Naun Qosja	1389	1.175-N	ska	50.00	50.00	ska	419	1776145	309,345.25	1,466,799.75	20,950	1,487,750.00	Konfirmuar nga ZRRPP Elbasan
2	Eduart Bajram Velaj	1389	1.77-N	ska	0.00	72.00	ska	419	1,989,065	480,691	1,508,374	shtet	1,508,374.00	Saktesim dokumentacioni
												TOTAL	2,996,124	

Shenim: 1. Vleresimi i ndertimit eshte bere ne perputhje me Udhезimin Nr 4 date 30/09/2015"Per miratimin e Kostos Mesatare te banesa nga enti kombetar I banesave per vitin 2015" si dhe Udhезimit Nr 21 date 26/02/2009te Ministrise Financave dhe Ministrise Drejtesise .

Shenim 2. Trualli eshte vleresimi sipas Nr 89 date 3/02/2016

KËRKESE

Shtetësja Nexhmije Beka (Hasanaj) kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë shpalljen të zhdukur të bashkëshortit të saj, shtetasin Ervin Hasanaj, dhe caktimin e kujdestarisë për pasurinë e tij.

Kërkuesja
Nexhmije Beka (Hasanaj)

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”

Çmimi 168 lekë